

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" CHE MI MTP" SHPK**

Sot me daten 12/01/2021 (dymijë e njëzet e një ), ne ortaket themelues :

- **1 Z. MARCO SPINELLI**, I biri i Giovani, shtetas Italian, i datëlindjes 16 Janar 1969, lindur në Verona,Itali dhe banues në Lavagno, Verona, Itali, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. AT 7664785.
- **2 ZNJ. NERTILA BEQIRI**, e bija e Ali, shtetase shqiptare, e datëlindjes 27 mars 1987, lindur në Lushnje ,Shqipëri, dhe banuese në Lagjjen nr 14, Durrës, disponuese e letërnjoftimit (kartë identiteti), me Nr. I75327097M.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Pergjegjësi të Kufizuar "CHE MI MTP" SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet "CHE MI MTP" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, DURRES, Lagjja nr 11, Rruga "Aleksander Goga",Zona kadastrale 8514, Godina me nr pasurie 1/279,Kati dyte.

**NENI 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e:

- Kryerja e instalimeve dhe montimeve të ndryshme për pajisjet dhe makineritë industriale si makineri mermeri, graniti, guri etj, eksport-import të pajisjeve dhe makinerive të ndryshme industriale.

**NENI 4**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë **CHE MI MTP" SHPK** është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.



Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon:

**1.MARCO SPINELLI, zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**

**1.NERTILA BEQIRI, zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**

**NENI 5**  
**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhe kohe të pacaktuar.

**NENI 6**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë **ZNJ.NERTILA BEQIRI**, e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo përfajje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

**NENI 7**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

**NENI 8**  
**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit finanziar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**  
**LIKUIDIMI**


Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**MOSMARRËVESHJET**


Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES I SHOQËRISË  
"CHE MI MTP" SH.P.K**

**MARCO SPINELLI**

  
Marco Spinelli  
S. M.

**NERTILA BEQIRI**

  
Nertila Beqiri  
N. B.